



KRYETARI I KRYEQYTETIT 30. 03. 2023, më 30. 03. 2023
A4-029/04-67868/23

Në bazë të nenit 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, nenit 53 të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01 nr.110-391, të dt.25.02.2010, Strategjisë nacionale për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali 2022-2026, Planit të Veprimit për zbatimin e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në shoqërinë kosovare 2022-2026, si dhe në bazë të shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.0-43 të datës 16.01.2023, Kryetari i Kryeqytetit merr këtë:

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMITETIT KOMUNAL VEPRUES NË KOMUNËN E PRISHTINËS

I. Formohet Komiteti Komunal Veprues në këtë përbërje:

1. Besianë Musmurati, Drejtore e Drejtorisë Arsimit, anëtare;
2. Adelina Sahiti, Drejtore e Drejtorisë për Mirëqenie Sociale, anëtare;
3. Betim Abdullahu, Zyrtar Komunal për Komunitete dhe Kthim, anëtar;
4. Klaudia Mula, Zyrtare Komunale për Komunitete dhe Kthim, anëtare;
5. Premtime Preniqi, Zyrtare për Drejtat e Njeriut dhe barazi gjinore, anëtare;
6. Eroll Raskova, Udhëheqës i Sektorit për Buxhet dhe Financave-Drejtoria e Financave, anëtar;
7. Sokol Gashi, Zyrtar për Gjeodezi- Drejtoria e Pronës, anëtar;
8. Astrit Muhaxhiri, Përfaqësues i Organizatës Ndërkombëtare - (Advancing Together) anëtar;
9. Fjolla Hoxha Tërmkolli, Përfaqësues i Organizatës Ndërkombëtare - Terre des Hommes anëtare;
10. Ridvan Gashi, Përfaqësues i shoqërisë civile - Multiethnik Culture of Kosovo, anëtar;
11. Amandë Toska, Përfaqësues i shoqërisë civile - VoRAE, anëtare.

II. Komiteti nga pika I e këtij Vendimi, bazuar në Planin e Veprimit për zbatimin e strategjisë për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës 2022-2026, dhe në bazë të Shkresës së Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal nr.0-43 të datës 16.01.2023 ka për detyrë monitorimin e zbatimit të strategjisë dhe planit të veprimit për avancimin e të drejtave të komuniteteve rom dhe ashkali në Republikën e Kosovës.

III. Komiteti Komunal Veprues do të shërbejë si një strukturë mbështetëse lokale për koordinimin e aktiviteteve me strukturat e nivelit qendror dhe monitorimit të zbatimit të planit të veprimit në nivel lokal.

IV. Komiteti Komunal Veprues do të udhëhiqet nga Kryetari ose Nënkryetari i Kryeqytetit.

V. Për zbatimin e këtij vendimi kujdeset kryetari i Kryeqytetit.

VI. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

T'U DËRGOHET:

- Anëtarëve të Komisionit,
- Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

KRYETARI I KRYEQYTETIT
Përparim Rama

